



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërrësuar / Punëdhënësi / Prilidat / Received / Delivered	01.06.2022	2	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org. Unit	Nr. Prot / Bil. Prot / Prot No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKM/SHCK	3207/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.407/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.407/2022 të datës 21.04.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit të datës 15.04.2022 të Udhëheqësit të Administratës në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë në Shërbimin Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore vërejte, në çështjen juridike "*masë disiplinore-vërejtje*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.407/2022 e datës 21.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. **Shfuqizohet** Vendimin KD.nr.015/2022 i datës 04.04.2022 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Vendimi i datës 15.04.2022 i Udhëheqësit të Administratës të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë në Shërbimin Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore vërejte ndaj ankuseses.

III. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ndaj ankueses e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në bazë të Akt Emërimit të datës 08.08.2019 në pozitën Zyrtare për Pranim dhe Lirim në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, më datë 28.02.2022 Udhëheqësi i Administratës së Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, ka inicuar procedurë disiplinorë pranë Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me arsyetimin që *“...në raportin e datës 28.01.2022 lidhur me përgatitjen e fletëlëshimit të lirimit të paraburgosurit me inicialet B.P, ku sipas aktvendimit për ndërprerjen e masës së paraburgimit i njëjti është dashur të lirohet më datë 30.01.2022 e jo 28.01.2022 siç është shkruar në fletëlëshim, dhe me këtë veprim ka shkelur detyrat e punës pikën 4, e cila shprehimisht thotë “Me rastin e lirimit të burgosurve të sigurohet se vendimi i Gjykatës është në rregull sipas përshkrimit të detyrave të punës i datës 15.07.2019...”*.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 04.04.2022 ka nxjerr Vendim KD.nr.015/2022 me të cilin ankuesja është liruar nga përgjegjësia disiplinor lidhur me shkeljet e rënda të detyrave të punës duke vlerësuar që veprimi i ankueses përbën shkelje të lehtë të detyrave të punës të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Udhëheqësi i Administratës i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, bazuar në vendimin e Komisionit Disiplinor, më datë 15.04.2022 ka nxjerr Vendim me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore “vërejtje”.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 15.04.2022 të Udhëheqësit të Administratës të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, fizikisht më datë 21.04.2022 ka parashtruar ankesë me Nr.Prot:2279/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se gjatë kësaj procedure disiplinore ka pasur shkelje procedurale, dhe aplikim të gabuar të gjendjes faktike dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 13.05.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:2279/2022 të datës 21.04.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.nr.015/2022 i datës 04.04.2022 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ftesë për Komisionin Disiplinor i datës 10.03.2022; Emailin e datës 10.03.2022 për ankuesen; Vendimin e datës 15.04.2022 për shqiptimin e masës disiplinore vërejte; Emailin e datës 13.04.2022 për ankuesen; Kërkesën për përgjigjen në ankesë e datës 27.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 13.05.2022; Akt Emërimit e datës 08.08.2019 në emër të ankueses; Inicimin e procedurës

disiplinore ndaj ankueses i datës 28.02.2022; Përshkrimi i detyrave të punës Zyrtar për Pranim dhe Lirim i datës 15.07.2019; Emailin e datës 11.02.2022 dhe 28.01.2022; Fletëlëshimi i datës 28.01.2022; Deklaratë e datës 23.02.2022 nga ankuesja; Aktvendimi PPPS.nr.47/2021 i Gjykatës Themelore-Departamenti Special në Prishtinë; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 16.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesa e parashtruar nga ankuesja, është e bazuar, **SEPSE**:

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 15.04.2022 të Udhëheqësit të Administratës të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje, pretendon se gjatë kësaj procedure disiplinore ka pasur shkelje procedurale, dhe aplikim të gabuar të gjendjes faktike dhe materiale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave materiale të çështjes, ka konstatuar se me Aktvendimin PPPS.nr.47/2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti Special në Prishtinë të paraburgosurit B.P i është zëvendësuar masa e paraburgimit në Arrest Shtëpiak nga data 30.01.2022 deri më datë 30.03.2022, ndërsa sipas kësaj ankuesja më datë 28.01.2022 ka përgatitur Fletëlëshimin ku është përshkruar që lirimi i të paraburgosurit bëhet më datë 28.01.2022, ndërsa në bazë të aktvendimit të lartcekur ky lirim është dashur të bëhet nga data 30.01.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i'u referua Vendimit KD.nr.015/2022 të datës 04.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në të cilin thuhet që gjatë hartimit të fletëlëshimit është përvjedhur një gabim teknik dhe i njëjti është përmirësuar nga zv. Drejtoresha, edhe pse konstatohet që veprimi final është përgjegjësi e drejtorit që të lëshoj fletëlëshimin, ndërsa ankuesja përmes deklaratës së datës 23.02.2022 ka deklaruar që ky gabim ka ndodh për shkak të mbingarkesës në punë për shkak që ka qenë vetëm në zyre, kështu që fletëlëshimi kontrollohet nga zyrtari ligjor e pastaj nënshkruhet nga drejtori por meqenëse zyrtari ligjor nuk ka qenë në punë kontrollimin e ka bërë zëvendës drejtoresha, andaj personi nuk është thirr fare për lirim, derisa fletëlëshimi të kontrollohet nga zëvendës drejtoresha dhe të nënshkruhet, kështu që është përmirësuar gabimi teknik dhe fletëlëshimi është nënshkruar.

Andaj duke u bazuar në atë që është konstatuar në Vendimin KD.nr.015/2022 të datës 04.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, deklaratën e datës 23.02.2022 të ankueses, deklaratën e ankueses pranë Komisionit Disiplinor dhe përshkrimin e detyrave të punës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesja gjatë përgatitjes së fletëlëshimit për të paraburgosurin B.P, ka bërë lëshim teknik dhe në asnjë dëshmi nuk është konstatuar që gabimi i saj ka qenë i qëllimshëm, kështu që gabimet teknike janë të mundshme dhe të njëjtat mund të korrigjohen sipas nenit 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që gabimi teknik është evidentuar dhe është bërë përmirësimi i tij pa u shkaktuar pasoja .

Meqenëse nga provat e lëndës, konstatohet që ankuesja gjatë përgatitjes së fletëlëshimit ka bërë gabim teknik të paqëllimshëm, sipas Kolegjit edhe veprimi i saj nuk mund të cilësohet si shkelje e nenit 46 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka përcaktuar se: *4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar*". Po ashtu me asnjë provë nuk është arritur të konstatohet se cili është dëmi dhe pasoja e shkaktuar nga veprimi i ankueses, andaj meqenëse nuk është shkaktuar dëmi respektivishtw pasoja pasi gabimi teknik është përmirësuar, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për ekzistimin e elementeve disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, elemente këto që duhet plotësuar kumulativisht në mënyrë që të ekzistoj përgjegjësia disiplinore, e në rastin konkret të ankueses, Udhëheqësi i Administratës së Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e tyre, duke mos marr për bazë dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në të lartcekurat, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses, është në kundërshtim me legjislacionin për zyrtarët publikë, respektivisht në kundërshtim me nenin 45, 46 paragrafi 4, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1 dhe 2, nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Si u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.407/2022, datë 01/06/2022

Avdy BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankueses
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe;
- ❖ Arkivat të KPMSHCK-së.

